



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 7 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 503/2 prot., datë 09.02.2024, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

1. Në lidhje me kërkesën tuaj të parë, ju informojmë se, referuar vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”, caktimi i datës dhe orës së gjykimit të çështjes së ardhur mbi ankim të palës, bëhet nga gjyqtari relator, në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit. Ndërsa në rastet kur gjykata e apelit vepron si gjykatë e shkallës së parë, gjyqtari relator e cakton datën dhe orën e seancës në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve duke mbajtur në konsideratë afatet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, i ndryshuar, apo në ligjet e veçanta. Në rast se Kodi i Procedurës Civile apo një ligj i veçantë nuk ka përcaktuar afat për gjykimin e çështjes kjo e fundit mund të përshejtohet vetëm mbi kërkesë të palëve, për shkak të natyrës dhe kategorisë specifike të çështjes ose për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin, sipas parashikimeve të Kreut II, të vendimit të mësipërm.

Kërkesat për përshejtim shqyrtohen rast pas rasti nga gjyqtari relator, i cili në përfundim mund ta vlerësojë atë si të bazuar ose jo. Kur kërkesa e palës për përshejtimin e shqyrtimit të çështjes vlerësohet e bazuar, gjyqtari relator parashtron dhe arsyet në të cilat është mbështetur për pranimin e saj.

2. Në lidhje me kërkesën tuaj të dytë, bashkëlidhur kësaj shkrese po ju vendosim në dispozicion dokumentacionin (në 10 fletë gjithsej) mbi propozimet për ndryshime ligjore të miratuara në mbledhjet e Grupit të Punës dhe të përcjella për veprime të mëtejshme Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të Shqipërisë të përcjella me anë të shkresës nr. 5627 prot., datë 26.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

-Projektligj për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 "*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*", të ndryshuar, dhe relacioni përkatës.

-Projektligj për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", të ndryshuar, dhe relacioni përkatës.

3. Në lidhje me kërkesën tuaj të tretë, ju informojmë se, bazuar në pikëm 1, të nenit 45, të Kodit të Procedurave Administrative, dhe në pikën 4, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, vetëm palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrin kopje të tyre. Nga ana tjetër, referuar pikës 3, të nenit 45, të këtij Kodi, por edhe nenit 17, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, këto dokumente të kërkuara nga ju përmbajnë të dhëna personale, tregtare dhe profesionale të kandidatëve në fjalë, ndaj nuk mund të vihen në dispozicion dhe të përdoren nga të tretë pa pëlqimin e tyre. Në rastin konkret, këta kandidatë, kanë dhënë pëlqimin për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave personale nga Këshilli i Lartë Gjyqësor vetëm për qëllimet e procedurave administrative respektive.

Ndërkohë, sa i përket vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët e kërkuar, ato mund t’i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, në kategorinë Akte Administrative Individuale, sikurse ju kemi informuar edhe nëpërmjet shkresës nr. 503/1 prot., datë 01.02.2024. Lidhur me publikimin e tyre, Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton në çdo rast detyrimin që buron nga neni 98 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sipas të cilit aktet administrative individuale të Këshillit, në lidhje me statusin e gjyqtarëve ose nëpunësve civilë gjyqësorë, publikohen vetëm pasi të redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!